



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KRYETARI
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 01/09/2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Supervizim në objektin Rikonstruksion i shkollës ‘Sotir Çapo’ dhe ndërtimi i palestrës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mbikëqyrja e punës së ndërtimit 71247000-1.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,857,411 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/**

2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

1,857,411 x 40%= 742,964.4 (shtatëqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë katër) lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP “(i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kështëve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$1,857,411 \times 20\% = 371,482.2$ (treqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy pikë dy) lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe piken 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

1.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1: Punime gërmimi në tokë “Kategoria A”
- b. NP-2: Ndërtime civile dhe industriale “Kategoria A”
- c. NP- 3 - Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada “Kategoria A”
- d. N.S-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre. “Kategoria A”
- e. N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese “Kategoria A”
- f. N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV “Kategoria A”

Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licences sipas marreveshjes së bashkepunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës.

2.3.3 Në lidhje me fuqinë punëtore të operatorit ekonomik kërkohet :

Për realizimin e punimeve kërkohet që shoqëria pjesëmarrëse të ketë mesatarisht 4 (katër) punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesa minimumi 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, duke përfshirë stafin e përhershëm:

➤ *Kjo pikë dokumentohet me vertetim të leshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore të rrethit përkates ose me vule elektronike . Listëpagesat për periudhën e mësipërme (E-sig 25)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma b) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtuesin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinier është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Shoqëria duhet të ketë në stafin e saj drejtues (në licensen e shoqërisë):

✓ Inxhinier ndërtimi	1 (një)
✓ Inxhinier elektrik	1 (një)
✓ Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
✓ Inxhinier Mekanik	1 (një)

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2, të jenë të shoqëruar me diplomë, kontrata pune, CV dhe licencë profesionale me kategoritë përkatëse.

Stafi drejtues i shoqërisë (ing. ndertimi, inxhinieri elektrik, hidroteknik, mekanik) duhet të jenë drejtues teknike në licensen e shoqërisë si dhe në listepagesat minimumi 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë pjesëmarrës në këtë prokurim, që stafi i inxhinierëve, të kërkuar më sipër, janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

Për këtë kriter, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- 1) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, të cilët duhet të figurojnë *minimumi 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.*
- 2) Listëpagesat përkatëse, shoqëruar me Formularin E-SIG 025/a dhe formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001-2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme), Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, siguri i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të

klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme), Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushton aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e këtij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme), Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

Argumentimi:

Standarti ISO **45001-2018** është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO **45001-2018** Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndërmarrjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurt pune, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e

punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbështetje të natyrës së objektit të prokurimit.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës:

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia
1	“Studim, projektim për objektin “Krijimi i një parku në Lagjen e Re”.	Shërbim	1

Sipas VKM Nr. 354, datë 18.5.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM” seksioni II neni 32, çdo ofertë ekonomike që rezultojn jashtë kufirit minimal dhe maksimal të vlerës do të skualifikohet.

Vlera e fondit limit: 1,665,680 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Informacione të tjera:

Seksioni: Strukturat në ambjentet e jashtme

Grupi tarifor IV

Vlera e projektimit duhet të jetë midis vlerave:

- ❖ Maksimalja: **1,331,980** (një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Për shërbimin topografik gjatë fazës së projektimit Shtojca 1, neni 72.

Grupi tarifor II

Vlera e shërbimit duhet të jetë midis vlerave:

- ❖ Maksimalja: **337,700** (një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Afatet e ekzekutimit: 2 (dy) muaj nga nënshkrimi i kontratës

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti: “Supervizim në objektin Rikonstruksion i shkollës ‘Sotir Çapo’ dhe ndërtimi i palestrës”

Vendodhja e Objektit:

Objekti me funksion shërbim dhe ndodhet në territorin e Njesisë Administrative Zharrëz, Bashkia Patos. Objekti kufizohet në krah të majtë me rrugën nacionale “Fier-Berat” dhe përballë me godinën e Njesisë Administrative Zharrëz. Zona Kadastrale: 3922. Nr. Pasurisë: 116/1

Qëllimi i objektit:

Shkolla e mesme “Sotir Capo” ka një frekuentim pothuajse nga të gjithë fëmijët e njesisë administrative Zharrëz si një nga shkollat më të rëndësishme të zonës. Nga ana tjetër pjesë e integruar në katin e parë të objektit me akses me vete është dhe kopështi për fëmijë “Fshati i Ri” i cili ka një frekuentim prej 20 fëmijësh. Aktualisht godina është në gjendje totalisht të rënduar si nga ana funksionale ashtu dhe infrastrukturore. Në objekt mungojnë salla ku mësimi të zhvillohet brenda parametrave normalë ku të jëtë ndriimi i duhur, sistemi i ngrohjes, kabinetet për zhvillimin e lëndëve të ndryshme të cilët kanë të domosdoshme demonstrime faktike. Përgjatë gjithë objektit dallojmë plasaritje të suvatimeve, lagështi, dyer dritare jo funksionale, tualete ne kushte shumë të këqija dhe disa prej tyre aspak funksionale. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri, sistemi i alarmit në rast emergjence mungojnë totalisht. Ndriçimi në disa salla është i ulët ose pothuajse fare. Referuar gjendjes aktuale ndërhyrja për rikonstruksionin e objektit është një domosdoshmëri me qëllim së pari ofrimin e kushteve minimale për zhvillimin e një mësimdhënie të rregullt, së dyti rritjen e numri të nxënësve të cilët janë larguar nga kjo shkollë për shkak të kushteve tejet të këqija me të cilat duhet të përballen. Me qëllim përmbushjen e kontratës dhe realizimin sipas projektit dhe specifikimeve teknike të punimeve mbikqyrësi duhet të kontrollojë gjatë gjithë periudhës së zbatimit mbarëvajtjen e punimeve deri në finalizimin e tyre.

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës të garancisë kur kërkohet nga investitori.

Objektivi kryesor i Mbikqyrësit:

Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyrësit

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyrësi menjëherë pas lidhjes së kontratës duhet:

1. Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emer të Autoritetit Kontraktor dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislacionit në fuqi.
2. Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve.
3. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyrjes, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.
4. Në bazë të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës Mbikqyrësi i punimeve duhet të jetë rezident me kohë pune të plotë në objekt, ndërsa stafi tjetër i mbikqyrjes mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesshme.
5. Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës etj.
6. Mbikqyrësi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mbikqyrësi ka për detyrë:

1. Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
2. Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe gati për të filluar punimet.
3. Të njihet me hollësi me kontratën e zbatimit të punimeve dhe të gjithë akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
4. Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:
 - Emërtimi i objektit:
 - Data e marrjes së lejes së ndërtimit:
 - Investitori:
 - Projektuesi:
 - Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik:
 - Mbikqyrësi:
 - Afati i ndërtimit të objektit:
 - Vlera e objektit:

Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet :

- a. Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese, treguese e të sigurisë, shiritave, fenerëve, etj.
- b. Mbasi verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin, si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku të përfshihen:
 - Stafi i Sipërmarrësit

- Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit
 - Pikat e marrjes së lëndëve të para inerte
 - Zonat e ngritjes së kantierit
- c. Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e Sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së zbatimit.
 - d. Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet, nëse ka, dhe ti propozojë Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.
 - e. Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të kontratave.
 - f. Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
 - g. Për çdo punim të maskuar të bëjë (fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbajë procesverbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
 - h. Në çdo fund dite pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe ta firmosë atë.
 - i. Të kontrollojë librezën e masave, e cila vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
 - j. Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt.
 - k. Gjatë zbatimit të projektit, i jep udhëzime me shkrim Sipërmarrësit, sa herë që e sheh të nevojshme dhe Sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit, ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me udhëzimet dhe urdhërat e marra.
 - l. Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyrësi i punimeve duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor një relacion të plotë teknik, shoqëruar me skicat përkatëse ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt, gjatë zbatimit të punimeve, do të bëhet vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor.
 - m. Korrespondenca ndërmjet palëve bëhet gjithnjë në mënyrë zyrtare, me shkrim.

Përgjegjësitë e Mbikqyrësit:

Në fillim të punimeve Mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Vendimin e sheshit të ndërtimit dhe lejen origjinale zhvillimore.
2. Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike.
3. Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.
4. Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
5. Saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

6. Për realizimin me korrektësi të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe Autoritetit Kontraktor, për realizimin e të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
7. Asnje punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipërmaresi duhet të njoftojë Mbikqyresin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.
8. Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Autoritetin Kontraktor, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.

Të drejtat e Mbikqyresit

Mbikqyresi ka të drejtë:

1. Të kërkojë largimin nga puna të Drejtuesit të Kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
2. Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, etj, nëse këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
3. Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materiale.
4. Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipërmarrësit.
5. Të mos lejojë vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe të zëvendësojë ato me materiale të tjera nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
6. Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecje të punimeve të sigurt dhe cilësore.
7. Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme nëse ato janë jashtë kushteve teknike.
8. Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga Mbikqyresi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmagjet e palejuara referuar standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit.
9. Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Sipërmarrësit.
10. Mbikqyresi i punimeve urdhëron Sipërmaresin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bera jo me cilësinë e parashikuar në projekt dhe specifikimet teknike.
11. Mbikqyresi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast, me miratimin e Autoritetit Kontraktor për atë kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast, sipas fajtit, Mbikqyresi së bashku me Autoritetin Kontraktor dhe Sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.

12. Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Kontraktor për gjendjen e tij.
13. Për çdo ndryshim të mundshëm në objekt, Mbikqyrësi i punimeve vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

Në përfundim të punimeve Mbikqyrësi:

Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara dhe miratuara si dhe të kushteve të kontrates dhe brenda 30 ditëve merr prej Kontraktorit dokumentacionin perkates.

Sipas legjislacionit në fuqi dorzon pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e Mbikqyrësit. Ky dokumentacion përgatitet e dorzohet në 3 (tre) kopje.

Të gjithë dokumentat që dorzohen pranë grupit të kolaudimit duhet të jenë origjinale.

Për kryerjen dhe realizimin e shërbimit të mbikqyrjes operatori ekonomik duhet të zbatojë dhe plotësojë të gjitha kërkesat sipas bazës ligjore si më poshtë:

1. Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
2. Udhëzimin Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.
3. Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.
4. Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Vendim nr. 448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe rregullave të kantierit”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose

produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria Projekteve dhe Emergjencave Civile pranë institucionit Bashkia Patos në përputhje me objektin e prokurimit dhe nevojat e autoritetit kontraktor.

Shenim:

Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitet miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 12.09.2025, ora 11:00.

NJËSIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Mitjon Nikolla

Ermenita Mici